



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-03

Vendosi: Gjykatëse An Pauër-Ford, Kryetare e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 qershor 2017

Gjuha origjinale: Anglishte

Titulli: Referimi i rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit

PUBLIKE

**KËRKESE PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS
në lidhje me Referimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe
të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit**

KRYETARJA E DHOMËS SË SPECIALIZUAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE, duke vepruar në bazë të nenit 3(8)(c) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji') dhe pas këshillimeve me gjykatësit e tjerë në përbërje të panelit të Gjykatës Kushtetuese të caktuar më 31 maj 2017 për shqyrtimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, kërkon ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në Holandë ('Shteti Pranues').

1. Më 31 maj 2017, në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese iu referuan rregullat e rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar më 29 maj 2017 nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara, me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
2. Po atë ditë, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit, caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e rregullave të rishikuara, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
3. Neni 3(8)(c) i Ligjit parashtron se:

Për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë ose të sigurisë,

...

c. ... Kryetari i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, sipas gjykimit të vet, gjithashtu mund të kërkojë ndryshim të vendit të zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në shtetin pranues, në mënyrë që Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të mblidhet, të shqyrtojë e të marrë dorëzime e parashtrime në selinë e Dhomave të Specializuara, në shtetin pranues.

4. Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese gjykon se administrimi i duhur i drejtësisë kërkon që vendi i zhvillimit të procedurës në lidhje me referimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të jetë në shtetin pranues, në mënyrë që Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të mblidhet e kuvendojë mbi rregullat e lartpërmendura dhe të marrë vendim në lidhje me to.

